

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 10.1.2020**

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN DHJETOR 2019**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 314 prot., datë 9.1.2020, përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, për muajin dhjetor 2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 25963 prot., datë 27.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 109/21 prot., datë 30.12.2019, paraqiti aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 , të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2019.

- Gjatë analizës së informacionit të paraqitur në këtë aplikim u evidentuan disa paqartësi dhe mangësi, në lidhje me llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike dhe kursin e këmbimit të cilin shoqëria ka përdorur, këto konstatime iu bënë me dije OSHEE sh.a. nëpërmjet komunikimit në adresën zyrtare elektornike të shoqërisë.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 75 prot., datë 8.1.2020, paraqiti aplikimin e saktësuar në të cilin ka llogaritur çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e FMF-së për muajin dhjetor 2019, në vlerën 16.57 lekë/kwh.

- Llogaritjet e OSHEE sh.a., si dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja, për muajin dhjetor , sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

**ÇMIMI I FMN-SË PËR MUAJIN DHJETOR 2019**

| <b>Dhjetor 2019</b>                                                                        |                 | <b>Aplikimi i OSHEE<br/>sh.a.<br/>Çmimi</b> | <b>Propozimi i ERE-s<br/>Çmimi</b> |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|---------------------------------------------|------------------------------------|
|                                                                                            | <b>Njësia</b>   |                                             |                                    |
| a) Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi | lekë/kwh        | 12.161                                      | 12.161                             |
| b) Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)                              | lekë/kwh        | 0.36                                        | 0.36                               |
| <b>c) Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante</b>                                  | <b>lekë/kwh</b> | <b>12.53</b>                                | <b>12.53</b>                       |
| d) Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit                              | lekë/kwh        | 1.79                                        | 1.79                               |
| e) Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit                                          | lekë/kwh        | 0.75                                        | 0.75                               |
| f) Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes                                          | lekë/kwh        | 1.50                                        | 1.50                               |
| <b>Çmimi i energjisë (c+d+e+f)</b>                                                         | <b>lekë/kwh</b> | <b>16.57</b>                                |                                    |

- Duke u bazuar në informacionin e aplikimit të muajit dhjetor, që shoqëria OSHEE sh.a. ka paraqitur në ERE, raportimeve periodike mujore për blerjen e energjisë elektrike në tregun e parregulluar, si dhe nga kontrolli i platformës *online*, ku shoqëria publikon informacionin e detajuar mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, rezulton se për këtë muaj nuk është zhvilluar asnjë procedurë për blerjen e energjisë nga tregu i parregulluar. Në vijim, shoqëria shprehet se në zbatim të metodologjisë për çmimin maksimal të blerjes së energjisë për këtë muaj i është referuar çmimit të energjisë nga prodhuesit me përparësi i cili është 0.1 €/kwh.

- Shoqëria OSHEE sh.a. deklaron se për llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike ka përdorur kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 26.12.2019, kjo për arsye të afateve kohore të mbylljes së ciklit të faturimit për muajin dhjetor 2019 për klientët FMF, meqenëse gjatë këtij muaji nuk ka pasur blerje energjie në treg të parregulluar për këta klientë.

- Duke iu referuar kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë prej 121.61 lekësh/eurosh, që shoqëria ka konsideruar në këtë aplikim, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga tregu i parregulluar rezulton të jetë 12,161 lekë/kwh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 266, datë 21.12.2018, “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a. për vitin 2019” është 0.75 lekë/kwh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.8.2018, në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 lekë/kwh.

- Për sa përcaktohet për çdo element të formulës përlllogaritëse rezulton që çmimi i shitjes nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin dhjetor 2019, të jetë 16.57 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 16.57 lekësh/kwh, për muajin dhjetor 2019.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti